



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 30

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9039 datë 27.3.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8088, datë 21.3.1996 "Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok".....	965
Ligj nr.9040 datë 27.3.2003	Për disa shtesa në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.1.1998.....	970
Ligj nr.9041 datë 27.3.2003	Për një shtesë në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat".....	970
Ligj nr.9042 datë 3.4.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)".....	971
Ligj nr.9043 datë 3.4.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit "Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë", ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)".....	981

Ligj nr.9044
datë 3.4.2003

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit “Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme, komponenti Lushnjë”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”..... 990

Dekret nr.3728
datë 13.3.2003

Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 1000

L I G J
Nr.9039, datë 27.3.2003

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8088, DATË 21.3.1996 "PËR
SHOQËRITË E BASHKËPUNIMIT RECIPROK"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8088, datë 21.3.1996 "Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Fjalja e parë e nenit 5 shfuqizohet.

Neni 2

Në fjalinë e parë të nenit 11 "Bashkimi i shoqërive", pas fjalës "bashkime" shtohen fjalët "ose shoqëri të reja".

Neni 3

Pas nenit 12 "Pjesëmarrja" shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 12/1
Statuti i shoqërisë

Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok kanë statutin e tyre, i cili përmban, veç të tjerave, edhe:

- a) emrin dhe selinë e shoqërisë;
- b) objektin e shoqërisë;
- c) rregullat që përcaktojnë nëse anëtarët e shoqërisë bëjnë pagesa shtesë, në mënyrë të pakufizuar/të kufizuar, deri në një shumë të caktuar (kufiri maksimal i detyrimit), për pasurinë, që është objekt i falimentimit, në rastin kur kreditorëve nuk mund t'u përmbushen detyrimet gjatë procesit të falimentimit;
- ç) rregullat për formën e thirrjes së asamblesë së përgjithshme të anëtarëve, rregullat e dokumentimit me shkrim të vendimeve, rregullat për drejtuesin e asamblesë së përgjithshme. Thirrja e asamblesë së përgjithshme bëhet nëpërmjet njoftimit të anëtarëve nga organi i shoqërisë ose nëpërmjet njoftimit në organet e medias;
- d) rregullat për formën e njoftimeve të shoqërisë, si dhe rregullat për njoftimin në organet e medias;
- dh) sasinë e kontributeve që derdh secili anëtar (kuotat e kapitalit), si dhe pagesat për çdo kuotë kapitali, për të cilat është i detyruar çdo anëtar;
- e) krijimin e rezervave të përmendura në nenet 43 e 44;
- ë) rregullat sipas së cilave veprimtaria e shoqërisë kufizohet për një periudhë të caktuar kohe;
- f) lidhjen që ekziston ndërmjet anëtarësimit dhe zgjatjes së tij me vendqëndrimin brenda një qarku të caktuar;
- g) rregullat për rrethanat në të cilat asambleja e përgjithshme nuk merr vendime me shumicë të thjeshtë votash;
- gj) rastet e përjashtimit të anëtarëve nga shoqëria;

h) kriteret e shpërndarjes së kontributeve në natyrë.”.

Neni 4

Në nenin 15 “Numri i anëtarëve” në paragrafin e parë, fjalët “7 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “3 anëtarë” dhe në fjalinë e fundit të paragrafit të parë fjalët “jo më pak se” bëhen “më pak se”.

Neni 5

Neni 17 “Humbja e cilësisë së anëtarit” ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Humbja e cilësisë së anëtarit

Anëtarësimi në shoqëri humbet kur anëtari heq dorë, përjashtohet nga shoqëria ose vdes. Çdo anëtar është i detyruar të njoftojë me shkrim, të paktën tre muaj më parë, heqjen dorë nga shoqëria. Largimi nga shoqëria bëhet vetëm në fund të vitit fiskal.

Anëtari i shoqërisë së bashkëpunimit reciprok që jep dorëheqjen ose që përjashtohet, mbetet i detyruar ndaj detyrimeve të shoqërisë për një periudhë prej pesë vjetësh në raport me pjesët që ka ai në kapitalin e shoqërisë.

Duke filluar nga çasti i njoftimit të vendimit për largim, anëtari nuk mund të marrë më pjesë në asamblenë e përgjithshme dhe nuk mund të jetë më anëtar i këshillit administrativ ose i këshillit mbikëqyrës.”.

Neni 6

Në nenin 23 “E drejta e votës” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nëse një anëtar nuk merr ose nuk mund të marrë pjesë në asamblenë e përgjithshme, autorizon me prokurë të posaçme një person tjetër të ushtrojë të drejtën e votës së tij në asamblenë e përgjithshme.”.

Neni 7

Në paragrafin e katërt të nenit 28 “Këshilli administrativ” shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në statut parashikohet mënyra e zëvendësimit të tij me anëtarë të tjerë të këshillit administrativ.

Anëtarët e këshillit administrativ të shoqërisë përgjigjen personalisht për dëmet që kanë shkaktuar për shkak të mospërbushjes së detyrimeve.”.

Neni 8

Neni 29 “Këshilli mbikëqyrës ” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Këshilli mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës është organ i kontrollit të shoqërisë mbi veprimtarinë administrative dhe financiare të saj. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë që zgjidhen prej asamblesë së përgjithshme nga radhët e anëtarëve të shoqërisë. Nëse është e nevojshme, asambleja e përgjithshme mund të zgjedhë më shumë se tre anëtarë për këshillin mbikëqyrës. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, edhe para përfundimit të periudhës kohore për të cilën është zgjedhur, bëhet nga asambleja e përgjithshme me tre të katërtat e votave të anëtarëve të pranishëm.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk lejohen që në të njëjtën kohë të jenë anëtarë të këshillit administrativ, me përjashtim të rasteve kur shoqëria përbëhet nga më pak se gjashtë anëtarë.

Këshilli mbikëqyrës nuk merr asnjë vendim dhe nuk mund të japë asnjë sanksion. Çdo vit ai i paraqet asamblesë së përgjithshme të zakonshme vjetore një raport për drejtimin e veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë. Këshilli mbikëqyrës mund t'i paraqesë një raport të tillë çdo asambleje të përgjithshme, ose mund të thërrasë një asamble të zakonshme ose të jashtëzakonshme për çdo problem të rëndësishëm që çmon se duhet diskutuar.

Këshilli mbikëqyrës mund të kërkojë në çdo kohë raport nga këshilli administrativ për veprimtarinë e tij dhe të shohë ose të ngarkojë anëtarët e tjerë për të parë dokumentet e shoqërisë.

Detyrat e tjera të këshillit mbikëqyrës përcaktohen në statut.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund t'ua delegojnë ushtrimin e detyrave të veta personave të tjerë.

Këshilli mbikëqyrës mund të pezullojë anëtarët e këshillit administrativ deri në një vendim të asamblesë së përgjithshme që thirret menjëherë dhe merr vendimet e duhura për shkak të vazhdimit të veprimtarisë.”.

Neni 9

Neni 39 “Kushtet e kthimit të pjesëve të kapitalit” ndryshohet si më poshtë:

"Neni 39

Kushtet e kthimit të pjesëve të kapitalit

Pjesa e kapitalit të shoqërisë, që i përket anëtarit që largohet nga shoqëria, përcaktohet sipas gjendjes së pasurisë të shoqërisë dhe numrit të anëtarëve. Ndarja bëhet në bazë të bilancit të fundit.”.

Neni 10

Në nenin 41 “Veprimtaria financiare” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Bilanci vjetor duhet të kontrollohet nga një ekspert kontabël i miratuar, i cili caktohet nga asambleja e përgjithshme dhe ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme pa të drejtë vote.”.

Neni 11

Në nenin 42 “Analiza e veprimtarisë”, pas fjalëve "tre muaj" shtohen fjalët "deri në katër muaj".

Neni 12

Në nenin 43 “Fondi i rezervës për mbulimin e rreziqeve” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Këto rezerva mund të përdoren vetëm për mbulimin e humbjeve të shkaktuara nga rreziqet. Shoqëria e bashkëpunimit reciprok mund të parashikojë në statut, kur e shikon të nevojshme, krijimin e rezervave të tjera. Në këtë rast statuti përcakton shumën që do të paguhet për këtë fond dhe subjektin që përdor fondin.”.

Neni 13

Në fund të nenit 44 “Fondi i rezervës ligjore” shtohet fjalia:

"Për këtë fond vendos asambleja e përgjithshme.”.

Neni 14

Në nenin 48 “Mosprekja e rezervave financiare”, në fjalinë e dytë fjalët "si dhe në rastin e likuidimit të saj" shfuqizohen.

Neni 15

Neni 49 "Përdorimi i fitimit neto" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 49

Përdorimi i fitimit neto

Asambleja e përgjithshme vjetore, pasi verifikon shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, të cilave u ka mbërritur afati i skadimit, vendos për përdorimin e fitimit neto, i cili do të përdoret vetëm për:

1. krijimin e rezervave të përcaktuara, sipas rregullave të statutit;
2. shpërblimet për veprimtarinë që anëtarët kanë kryer me shoqërinë e bashkëpunimit reciprok;
3. vlerën që do të paguhet për prodhimet dhe shërbimet e realizuara nga anëtarët e shoqërisë ose për të ulur kostot e blerjes së pasurisë, shërbimeve, si dhe për shlyerjen e kredive.

Në statut përcaktohet radha e mëtejshme e shpërndarjes."

Neni 16

Fjala e dytë e nenit 51 "Mbulimi i humbjeve" ndryshohet si më poshtë:

"Kur këto fonde mbarohen, humbjet mbulohen nga rezervat ose fonde të tjera të parashikuara në statut."

Neni 17

Neni 55 "Përfashtimi nga tatimet" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 55

Përfashtimi nga tatimet

Shoqëria e bashkëpunimit reciprok është e tatueshme. Përfashtohen nga tatimet shoqëritë e bashkëpunimit reciprok në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral për pesë vitet e para të veprimtarisë së tyre. Këto shoqëri e humbasin këtë të drejtë kur ato bashkohen me shoqëri të tjera që nuk janë të përfashtuara nga tatimet."

Neni 18

Neni 60 "Mbetjet pas likuidimit" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 60

Mbetjet pas likuidimit

Pas likuidimit të të gjitha detyrimeve dhe pagesës së pjesëve të kapitalit, në rast se rezultojnë mbetje, ajo ndahet ndërmjet anëtarëve të shoqërisë."

Neni 19

Nenet 45, 46 dhe 47 të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 "Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok" shfuqizohen.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3790, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9040, datë 27.3.2003

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7892, DATË 21.12.1994
“PËR SPONSORIZIMET”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8282,
DATË 21.1.1998

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.1.1998, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 5 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në shkronjën “c”, pas fjalëve “shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit” shtohen fjalët “dhe botimet e veprat letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore, artistike e sportive”.

2. Në fund të këtij neni shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe masat e sponsorizimit nga personat juridikë publikë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3791, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9041, datë 27.3.2003

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002
“PËR AKCIZAT”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, në nenin 19 “Përjashtimet”, në pikën 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“për gazoilin e shitur për anijet e peshkimit në sasitë, kushtet dhe personat e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet e tij ligjore më 1 korrik 2003.

**Shpallur me dekret nr.3792, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9042, datë 3.4.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË, KAVAJA II, MANSKURIA” NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (KFW)”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, e financimit dhe e projektit “Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3782, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
**PËR HUA, FINANCIM DHE PROJEKT NDËRMJET KFW-SË DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, TIRANË, SI
DHE NGA NDËRMARRJA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE KAVAJË (AGJENCIA
ZBATUESE) PËR 2 045 167,52 EURO-HUA (INVESTIM)
DHE 1 533 875,64 EURO-KONTRIBUT FINANCIAR (MASA SHOQËRUESE) UJËSJELLËSI
RURAL I KAVAJËS II (MANSKURIA)**

Në bazë të një marrëveshjeje që pritet të përfundojë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunim financiar (marrëveshje

qeveritare), Huamarrësi “Agjencia zbatuese” dhe KfW-ja me anë të kësaj lidhin këtë Marrëveshje për hua, financim dhe projekt.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi

1.1 KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon shumën 2 045 167,52 euro (investimi) dhe një kontribut financiar që nuk kalon shumën 1 533 875,64 euro (masa shoqëruese).

Kontributi financiar nuk mund të ripaguhet, vetëm nëse artikulli 4.2 parashikon ndryshe.

1.2 Huamarrësi do t’ia kalojë të gjithë shumën e huasë dhe kontributin financiar Agjencisë zbatuese në përputhje me kushtet e përcaktuara në artikullin 2. Agjencia zbatuese do ta përdorë huanë vetëm për financimin e nxjerrjes, transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për zonën e ujësjellësit të Kavajës, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës dhe kontributin financiar vetëm për mbështetjen institucionale që shoqëron këtë proces, së pari për të mbuluar koston e shkëmbimit të huaj. Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar në një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe tatime të tjera publike të hasura nga Huamarrësi ose Agjencia zbatuese, si dhe taksat e importit nuk do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar.

Neni 2

Kalimi i huasë dhe kontributit financiar tek Agjencia zbatuese

2.1 Huamarrësi do ta kalojë huanë tek Agjencia zbatuese në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në nenin 4.2 dhe 4.4 të kësaj Marrëveshjeje.

2.2 Huamarrësi do ta kalojë kontributin financiar tek Agjencia zbatuese në formën e një granti të pakthyeshem në përputhje me një marrëveshje të veçantë financimi.

2.3 Përpara disbursimit të parë nga huaja dhe kontributit financiar, Huamarrësi do t’i dorëzojë KfW-së një kopje të marrëveshjes së cilës i referohet neni 2.1 dhe 2.2.

2.4 Kalimi i huasë dhe kontributit financiar nuk përbën asnjë detyrim ligjor të Agjencisë zbatuese kundrejt KfW-së në lidhje me detyrime për pagesat që kjo Marrëveshje përcakton.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja do bëjë disbursimin e huasë dhe të kontributit financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë zbatuese. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë metodat e disbursimit, veçanërisht provat që do të vërtetojnë që fondet e tërhequra përdoren për qëllimet e përcaktuara.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor të vitit 2006.

Neni 4

Interesat dhe ripagimi i huasë

4.1 Huamarrësi do të paguajë një taksë angazhimi prej 0.25% në vit për shumën e padisbursuar të huasë. Kjo taksë do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që përfundon në datën kur disbursimet debitohen.

4.2 Huamarrësi do të paguajë një interes për huanë prej 0.75% në vit. Interesi do të zbatohet duke filluar nga data e debitimit të disbursimit, deri në datën e bërjes së pagesave në llogarinë bankare të KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do t’i paguajë interesat dhe çdo interes për vonesa në pagime në bazë të nenit 4.5, në 30 qershor dhe në 30 dhjetor për gjysmën e vitit në përfundim. Detyrimi i parë do të shlyhet në të njëjtën kohë me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të paguajë huanë si vijon.

KëstiDatëShuma

130	Dhjetor2012	Euro34 000, 00
230	Qershor2013	Euro34 000, 00
330	Dhjetor2013	Euro34 000, 00
430	Qershor2014	Euro34 000, 00
530	Dhjetor2014	Euro34 000, 00
630	Qershor2015	Euro34 000, 00
730	Dhjetor2015	Euro34 000,00
830	Qershor2016	Euro34 000,00
930	Dhjetor2016	Euro34 000,00
1030	Qershor2017	Euro34 000,00
1130	Dhjetor2017	Euro34 000,00
1230	Qershor2018	Euro34 000,00
1330	Dhjetor2018	Euro34 000,00
1430	Qershor2019	Euro34 000,00
1530	Dhjetor2019	Euro34 000,00
1630	Qershor2020	Euro34 000,00
1730	Dhjetor2020	Euro34 000,00
1830	Qershor2021	Euro34 000,00
1930	Dhjetor2021	Euro34 000,00
2030	Qershor2022	Euro34 000,00
2130	Dhjetor2022	Euro34 000,00
2230	Qershor2023	Euro34 000,00
2330	Dhjetor2023	Euro34 000,00
2430	Qershor2024	Euro34 000,00
2530	Dhjetor2024	Euro34 000,00
2630	Qershor2025	Euro34 000,00
2730	Dhjetor2025	Euro34 000,00
2830	Qershor2026	Euro34 000,00
2930	Dhjetor2026	Euro34 000,00
3030	Qershor2027	Euro34 000,00
3130	Dhjetor2027	Euro34 000,00
3230	Qershor2028	Euro34 000,00
3330	Dhjetor2028	Euro34 000,00
3430	Qershor2029	Euro34 000,00
3530	Dhjetor2029	Euro34 000,00
3630	Qershor2030	Euro34 000,00
3730	Dhjetor2030	Euro34 000,00
3830	Qershor2031	Euro34 000,00
3930	Dhjetor2031	Euro34 000,00
4030	Qershor2032	Euro34 000,00
4130	Dhjetor2032	Euro34 000,00
4230	Qershor2033	Euro34 000,00
4330	Dhjetor2033	Euro34 000,00
4430	Qershor2034	Euro34 000,00
4530	Dhjetor2034	Euro34 000,00
4630	Qershor2035	Euro34 000,00
4730	Dhjetor2035	Euro34 000,00
4830	Qershor2036	Euro34 000,00
4930	Dhjetor2036	Euro34 000,00
5030	Qershor2037	Euro34 000,00
5130	Dhjetor2037	Euro34 000,00

5230 Qershor2038	Euro34 000,00
5330 Dhjetor2038	Euro34 000,00
5430 Qershor2039	Euro34 000,00
5530 Dhjetor2039	Euro34 000,00
5630 Qershor2040	Euro34 000,00
5730 Dhjetor2040	Euro34 000,00
5830 Qershor2041	Euro34 000,00
5930 Dhjetor2041	Euro34 000,00
6030 Qershor2042	Euro39 167,52
Total	Euro 2 045 167,52

4.5 Nëse këstet nuk paguhen në kohë, KfW-ja rezervon të drejtën të rrisë përqindjen e interesit për vonesat në pagesë sipas përqindjes së interesit të bankës gjermane në datën përkatëse duke i shtuar 3 % në vit për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur kjo pagesë derdhet në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9 të kësaj Marrëveshjeje. Në rast të mospagesave të interesave, KfW-ja ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. Këto dëmshpërblime nuk do ta kapërcejnë shumën momentale, në qoftë se interesat llogariten në kurs zbritës të Deutsche Bundesbank të datës së maturimit plus 3% në vit.

4.6 Taksa e angazhimit, interesi, si dhe çdo taksë për mospagesa sipas nenit 4.5 do të llogariten në bazë të vitit 360 ditësh dhe muajit 30 ditësh.

4.7 Sasi të huasë të padisbursuara ose të ripaguara përpara afatit do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha transheve të shlyerjes të papaguara përveçse kur KfW-ja vendos vetë sipas një mënyre të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave më të vogla.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas dëshirës së saj, pagesat e mbërritura kundrejt pagesave që janë për t'u kryer sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së me nr. 22.0256.0801 në Landeszentralbank, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00), nuk lejohen kundërankimet kundrejt këtyre pagesave.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e parakohshme

5.1 Huamarrësi mundet që në çdo kohë:

a) të mos plotësojë detyrimet e tij në bazë të nenit 8, të anulojë çdo shumë të huasë të padisbursuar;

b) të paguajë huanë në tërësi ose pjesërisht përpara afatit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç rastit kur:

a) Huamarrësi ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj KfW-së, për kryerjen e pagesave në kohë;

b) janë shkelur detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet e veçanta, që janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje;

c) Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të vërtetojë se shumatat e huasë dhe të kontributit financiar janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;

d) krijohen rrethana të veçanta që bëjnë të pamundur ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit, ose pagesën e detyrimeve financiare të Huamarrësit të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5.3 Nëse rrethanat e përcaktuara në nenin 5.2 a), b) ose c) janë krijuar dhe nuk janë eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë të paktën prej 30 ditësh, KfW-ja mund:

a) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 a), kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të huasë të disbursuara, si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrime të tjera të rastit.

b) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 b), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të kontributit financiar, si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrime të tjera të rastit.

c) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 c), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të tilla të huasë dhe kontributit financiar, për të cilat Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të provojë

se janë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

Neni 6

Kostoja dhe pagesat publike

6.1 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat e përcaktuara nga kjo Marrëveshje pa zbritur nga këto të fundit taksat, pagesat publike, si dhe kosto të tjera dhe do të mbulojë koston e transferimit dhe të shkëmbimit që kanë të bëjnë me disbursimin e huasë.

6.2 Huamarrësi do të mbulojë koston e të gjitha taksave dhe shpenzimeve të tjera publike, jashtë territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e huasë, marrëveshje për projekte dhe financim, si dhe përfaqësuesia

7.1 Përpara disbursimit të parë, Huamarrësi do të sigurojë prova të kënaqshme për KfW-në, të cilat vërtetojnë që Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhje me kushtetutën e tij, si dhe ligjet e tjera për marrjen e vlefshme mbi vete të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

7.2 Ministri i Financave dhe individë, të përcaktuar nga ai me specimen tek KfW-ja dhe të autorizuar nga ai, do të përfaqësojnë Huamarrësin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së zbatimit dhe individë të tillë të përcaktuar nga ai do të përfaqësojnë Agjencinë zbatuese në zbatimin e Marrëveshjes. Prokurat nuk do të përfundojnë derisa KfW-ja të marrë njoftimin për anulimin e tyre nga përfaqësuesit e autorizuar.

7.3 Amendamente ose adendume të kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftime të bëra nga Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim. Njoftimet dhe komunikimet do të dërgohen në adresat e mëposhtme, siç janë përcaktuar nga Palët Kontraktuese.

Për KfW-në

Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Telefax: + 49 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin

Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Al- Tirana
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese

Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizimeve Kavajë
Al – Kavajë/ Shqipëri
Telefax: + 355 554 4443

7.4 Amendamente të kësaj Marrëveshjeje, që kanë të bëjnë vetëm me marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë zbatuese.

Neni 8

Projekti

8.1 Agjencia zbatuese:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe do t'u përmbahet praktikave të drejta financiare dhe ndërtuese në lidhje me projektin, si dhe në përputhje me idenë e projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet KfW-së dhe Agjencisë zbatuese;

b) do të zgjedhë firma konsulente independente dhe të kualifikuara për përgatitjen dhe

mbikëqyrjen, dhe firma të kualifikuara për zbatimin e projektit;

c) do të akordojë kontratat për mallrat dhe shërbimet, të cilat do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar në përputhje me procedurat ndërkombëtare të tenderimit;

d) do të mbajë të dhëna, të cilat tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për projektin dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë tipin e mallit dhe të shërbimit të financuar nga kjo hua dhe këto kontribute financiare;

e) do të bëjë të mundur që përfaqësues të KfW-së të mundin në çdo kohë t'i kontrollojnë këto të dhëna, si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zbatimin e projektit, si dhe të vizitojnë zonën e projektit, si dhe objektet përkatëse;

f) do t'i sigurojë KfW-së dhe Ministrisë së Financave çdo informacion dhe të dhëna mbi projektin dhe mbi ecurinë e tij sipas kërkesës së KfW-së ose të Ministrisë së Financave;

g) do të sigurojë që ka përgjegjësinë zyrtare dhe të drejtat e përdoruesit për digën e Manskurias në mënyrë ligjore, përpara fillimit të punimeve të projektit;

h) do të ketë siguruar pronësinë e parcelave që nevojiten për objektet e trajtimit dhe për rezervuarët përpara tenderimit të punimeve përkatëse;

i) do të ketë siguruar licencën për nxjerrjen e ligjshme të ujit nga diga e Manskurias;

j) do të ketë lidhur një marrëveshje me shkrim me ujësjellësin e Durrësit mbi ndarjen e zonave përkatëse të shërbimit.

8.2 Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e nenit 8.1 nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit duke siguruar një vetëkontribut minimal prej 0.51 milionë euro dhe, nëse i kërkohet, t'i sigurojë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk mbulohen nga huaja ose nga kontributi financiar janë mbuluar;

b) me iniciativën e tyre, të informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të sigurojë që, përpara disbursimit të parë të fondeve të projektit për mallrat dhe shërbimet nga pjesa e investimit, të gjitha borxhet dhe detyrimet e mbledhura nga Agjencia zbatuese deri në datën e kthimit të saj në një shoqëri aksionere, janë shlyer ose marrë përsipër nga një palë e tretë.

8.5 Huamarrësi do të asistojë në Agjencinë zbatuese në përputhje me praktika të drejta financiare dhe ndërtuese gjatë zbatimit të projektit, si dhe në shlyerjen e detyrimeve të Agjencisë zbatuese, që përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe, veçanërisht, t'i akordojë Agjencisë zbatuese të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

8.6 Transporti i mallrave që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar do t'i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjes qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese do të sigurojnë se personat e përgjegjshëm për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, për dhënien e kontratës mbi mallrat dhe shërbimet që do të financohen, dhe që bëjnë kërkesën për disbursimin e shumave të huasë, të mos kërkojnë, japin, premtojnë ose marrin premtimin për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk është e vlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të qëndrojnë të pandryshueshme. Boshllëqet e krijuara si pasojë do të mbushen nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese e projektit nuk mund të caktojnë, transferojnë, garantojnë ose hipotekojnë një të drejtë të tyre të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga legjislatura e Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i punës do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në lidhje me interpretimin e

Marrëveshjes, do të mbizotërojë teksti në gjuhën gjermane.

9.5 Të gjitha konfliktet që vijnë nga kjo Marrëveshje, si dhe ato mbi vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve Kontraktuese, do t'u nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo Marrëveshje për projekt, hua dhe financim nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë sa marrëveshja qeveritare, mbi të cilën ajo bazohet, nuk ka hyrë në fuqi.

Nënshkruar në 6 kopje origjinale, tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

KREDITANSTALT FÜR WIEDERAUFBAU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga Ministria e Financave

Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizimeve Kavajë

Republika e Shqipërisë

Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese

Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizimeve Kavajë

Al – Kavajë/ Shqipëri

Telefax: + 355 554 4443

MARRËVESHJE ARBITRAZHI

Në mbështetje të Nenit 9.4 të Marrëveshjes së Projektit për Hua dhe Financim, Ndërmjet KfW-së dhe REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) përfaqësuar nga MINISTRIA E FINANCAVE Tiranë, si dhe NDËRMARRJA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE KAVAJË (Agjencia zbatuese) për Ujësjellësin E Kavajës II (Manskuria)

KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Të gjitha konfliktet në lidhje me Marrëveshjen për hua dhe financim projekti, si dhe në lidhje me vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht nga Palët Kontraktuese do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjyq arbitrazhi.

Neni 2

Palët në procedurat e arbitrazhit do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. KfW-ja ka të drejtën të nisë veprime kundër Huamarrësit dhe Agjencisë zbatuese, në mënyrë të ndarë ose të përbashkët. Po kështu, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese kanë të drejtën të nisin veprimet së bashku ose individualisht kundër KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjyqtaria e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar si vijon: një gjyqtar do të emërohet nga Huamarrësi ose, nëse Huamarrësi nuk ka ndërhyrë akoma në procedura, nga Agjencia zbatuese, gjyqtari i dytë nga KfW-ja dhe gjyqtari i tretë (kryetari) do të emërohet me marrëveshje të Palëve ose, nëse Palët nuk bien dakord brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga i akuzuari, do të emërohet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë ose, në rastin e dështimit, do të emërohet nga Kryetari i Komitetit Kombëtar të Zvicrës i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse njëra nga Palët dështon në emërimin e gjyqtarit ai do të emërohet nga kryetari.

3.2 Në rast se një arbitruer i emëruar në përputhje me dispozitat paraardhëse dëshiron të japë dorëheqjen ose është i paafte për të vepruar si arbitruer, pasardhësi i tij emërohet në të njëjtën mënyrë.

Pasardhësi ka të njëjtat kompetenca si dhe arbitruesi fillestar.

Neni 4

4.1 Procedurat e arbitrazhit do të fillojnë me anë të dorëzimit të një komunikimi me shkrim të akuzës së një pale kundrejt palës tjetër. Ky komunikim duhet të japë natyrën e akuzës, kompensimi që kërkohet, si dhe emrin e gjyqtarit që akuzuesi ka emëruar, në rastin kur akuzuesi është i autorizuar të emërojë një gjyqtar, siç e parashikon neni 3.1 i kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Tridhjetë ditë pas marrjes së komunikimit, i akuzuari duhet të njoftojë akuzuesin për emrin e gjyqtarit të emëruar nga ai, në rastin kur i akuzuari është i autorizuar të emërojë një gjyqtar në përputhje me nenin 3.1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Gjykata e arbitrazhit do të mblidhet në kohën e përcaktuar nga kryetari. Në rastin kur Palët nuk kanë rënë dakord për vendin ku do të zhvillohen procedurat e arbitrazhit, vendi do të përcaktohet nga kryetari.

Neni 6

Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë në bazë të kompetencave të tij. Ai do të përcaktojë procedurat e tij në përputhje me rregulla procedure të pranuara gjerësisht. Në çdo rast, Palët kanë të drejtën e një shpjegimi në një seancë të rregullt. Gjyqi i arbitrazhit mund të marrë vendim, edhe nëse njëra nga Palët dështon të paraqitet në proces. Të gjitha vendimet e gjyqit të arbitrazhit kërkojnë aprovimin e të paktën dy prej gjyqtarëve.

Neni 7

Gjyqi i arbitrazhit do të japë vendimin së bashku me arsyet shoqëruese me shkrim. Vendimi i nënshkruar nga të paktën dy gjyqtarë do të përbëjë dhe vendimin e gjyqit të arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një kopje të nënshkruar të vendimit. Vendimi është ligjërisht detyrues dhe përfundimtar. Duke nënshkruar këtë Marrëveshje të dy Palët pranojnë detyrimin për t'iu nënshtruar këtij vendimi.

Neni 8

8.1 Palët bien dakord për shpërblimin e gjyqtarëve dhe individëve të tjerë që do të nevojiten për kryerjen e procedurave të arbitrazhit.

8.2 Në rastin kur Palët nuk bien dakord përpara mbledhjes së gjyqit të arbitrazhit, gjyqi i arbitrazhit do të përcaktojë një shpërblim të përshtatshëm. Secila Palë do të mbulojë shpenzimet e saj në lidhje me procedurat e arbitrazhit. Kostoja e gjyqit të arbitrazhit do të mbulohet nga Pala kundër së cilës do të merret vendimi. Nëse vendimi nuk do të jetë plotësisht në favor të asnjërës nga Palët, kostoja do të mbulohet nga të dy Palët, në mënyrë të barabartë.

8.3 Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë përfundimisht për të gjitha çështjet që lidhen me koston.

8.4 Palët janë ligjërisht të detyruara, individualisht ose së bashku, për pagimin e shpërblimit të individëve të përcaktuar në nenin 8.1.

Neni 9

Të gjithë njoftimet e bëra nga Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit në lidhje me procedurat e arbitrazhit do të jenë me shkrim. Njoftime të tilla do të merren pasi të dërgohen në adresat e mëposhtme të Palëve Kontraktuese përkatëse.

Për KfW-në

Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany
Telefax: + 49 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin

Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Al- Tirana
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese

Ndërmarrja e Ujës-jellës-Kanalizimeve Kavajë
Al – Kavajë/ Shqipëri
Telefax: + 355 554 4443

Nënshkruar në gjashtë kopje origjinale, tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

L I G J
Nr.9043, datë 3.4.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË I SHQIPËRISË SË MESME, KOMPONENTËT BERAT
DHE KUÇOVË”, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS GJERMANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KfW)”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, e financimit dhe e projektit “Furnizimi me ujë i Shqipërisë
së Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës
Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3783, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
PËR HUA, FINANCIM DHE PROJEKT NDËRMJET KfW-SË DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (HUAMARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE TIRANË, SI
DHE NDËRMARRJES SË UJËSJELLËSIT BERAT DHE KUÇOVË (AGJENCIA ZBATUESE)
PËR 6 646 794, 46 EURO-HUA

(Investim)

Ujësjiellës për Shqipërinë e Mesme

Komponenti Berat dhe Kuçovë

Në bazë të një marrëveshjeje që pritet të përfundojë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunim financiar (marrëveshje qeveritare), Huamarrësi “Agjencia zbatuese” dhe KfW-ja me anë të kësaj lidhin këtë Marrëveshje për hua, financim dhe projekt.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi

1.1 KfW-JA do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon shumën 6 646 794,46 euro (investimi).

1.2 Huamarrësi do t’ia kalojë të gjithë shumën e huasë Agjencisë zbatuese në përputhje me kushtet e përcaktuara në artikullin 2. Agjencia zbatuese do të përdorë huanë vetëm për financimin e nxjerrjes, transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për Beratin dhe Kuçovën, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës, kryesisht për të mbuluar koston e shkëmbimit. Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe tatime të tjera publike të hasura nga Huamarrësi ose Agjencia zbatuese, si dhe taksat e importit nuk do të financohen nga huaja.

Neni 2

Kalimi i huasë tek Agjencia zbatuese

2.1 Huamarrësi do ta kalojë huanë tek Agjencia zbatuese në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në nenin 4.2 dhe 4.4 të kësaj marrëveshjeje.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi do t’i dorëzojë KfW-së një kopje të marrëveshjes së cilës i referohet neni 2.1 dhe 2.2.

2.3 Kalimi i huasë nuk përbën asnjë detyrim ligjor të Agjencisë zbatuese kundrejt KfW-së në lidhje me detyrime për pagesat që kjo Marrëveshje përcakton.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja do bëjë disbursimin e huasë në përputhje me ecurinë e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë zbatuese. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë metodat e disbursimit, veçanërisht provat që do të vërtetojnë që fondet e tërhequra përdoren për qëllimet e përcaktuara.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor të vitit 2006.

Neni 4

Taksa e angazhimit, interesi dhe ripagimi i huasë

4.1 Huamarrësi do të paguajë një taksë angazhimi prej 0.25% në vit për shumën të padisbursuar të huasë. Kjo taksë do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që përfundon në datën kur disbursimet debitoohen.

4.2 Huamarrësi do të paguajë një interes për huanë prej 0.75% në vit. Interesi do të zbatohet duke filluar nga data e debitimit të disbursimit deri në datën e bërjes së pagesave në llogarinë bankare të KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë interesat dhe çdo interes për vonesa në pagesë në bazë të nenit 4.5, në 30 qershor dhe në 30 dhjetor për gjysmën e vitit në përfundim. Detyrimi i parë i angazhimit do të shlyhet së bashku në pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të ripaguajë huanë si vijon:

KëstiDatëShuma

130 Dhjetor2012Euro111 000,00
 230 Qershor2013Euro111 000,00
 330 Dhjetor2013Euro111 000,00
 430 Qershor2014Euro111 000,00
 530 Dhjetor2014Euro111 000,00
 630 Qershor2015Euro111 000,00
 730 Dhjetor2015Euro111 000,00
 830 Qershor2016Euro111 000,00
 930 Dhjetor2016Euro111 000,00
 1030 Qershor2017Euro111 000,00
 1130 Dhjetor2017Euro111 000,00
 1230 Qershor2018Euro111 000,00
 1330 Dhjetor2018Euro111 000,00
 1430 Qershor2019Euro111 000,00
 1530 Dhjetor2019Euro111 000,00
 1630 Qershor2020Euro111 000,00
 1730 Dhjetor2020Euro111 000,00
 1830 Qershor2021Euro111 000,00
 1930 Dhjetor2021Euro111 000,00
 2030 Qershor2022Euro111 000,00
 2130 Dhjetor2022Euro111 000,00
 2230 Qershor2023Euro111 000,00
 2330 Dhjetor2023Euro111 000,00
 2430 Qershor2024Euro111 000,00
 2530 Dhjetor2024Euro111 000,00
 2630 Qershor2025Euro111 000,00
 2730 Dhjetor2025Euro111 000,00
 2830 Qershor2026Euro111 000,00
 2930 Dhjetor2026Euro111 000,00
 3030 Qershor2027Euro111 000,00
 3130 Dhjetor2027Euro111 000,00
 3230 Qershor2028Euro111 000,00
 3330 Dhjetor2028Euro111 000,00
 3430 Qershor2029Euro111 000,00
 3530 Dhjetor2029Euro111 000,00
 3630 Qershor2030Euro111 000,00
 3730 Dhjetor2030Euro111 000,00
 3830 Qershor2031Euro111 000,00
 3930 Dhjetor2031Euro111 000,00
 4030 Qershor2032Euro111 000,00
 4130 Dhjetor2032Euro111 000,00
 4230 Qershor2033Euro111 000,00
 4330 Dhjetor2033Euro111 000,00
 4430 Qershor2034Euro111 000,00
 4530 Dhjetor2034Euro111 000,00
 4630 Qershor2035Euro111 000,00
 4730 Dhjetor2035Euro111 000,00
 4830 Qershor2036Euro111 000,00
 4930 Dhjetor2036Euro111 000,00
 5030 Qershor2037Euro111 000,00
 5130 Dhjetor2037Euro111 000,00
 5230 Qershor2038Euro111 000,00
 5330 Dhjetor2038Euro111 000,00

5430 Qershor2039Euro	111 000,00
5530 Dhjetor2039Euro	111 000,00
5630 Qershor2040Euro	111 000,00
5730 Dhjetor2040Euro	111 000,00
5830 Qershor2041Euro	111 000,00
5930 Dhjetor2041Euro	111 000,00
6030 Qershor2042Euro	106 794,96
Total	Euro6 464 794,46

4.5 Nëse këstet nuk paguhen në kohë, KfW-ja rezervon të drejtën të rrisë përqindjen e interesit për vonesat në pagesë sipas përqindjes së interesit të bankës gjermane në datën përkatëse duke i shtuar 3% në vit për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur kjo pagesë derdhet në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9 të kësaj Marrëveshjeje. Në rast të mospagesave të interesave, KfW-ja ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. Këto dëmshpërblime nuk do të kapërcejnë shumën momentale, në qoftë se interesat llogariten në kurs zbritës të Deutsche Bundesbank të datës së maturimit plus 3% në vit.

4.6 Tarifa e angazhimit, interesi, si dhe çdo taksë për mospagesa sipas nenit 4.5 do të llogaritet në bazë të vitit 360 ditësh dhe muajit 30 ditësh.

4.7 Sasi të huasë të padisbursuara ose të ripaguara përpara afatit do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha transheve të shlyerjes së papagauara, përveçse kur KfW-ja vendos vetë sipas një mënyre të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave më të vogla.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas dëshirës së saj, pagesat e mbërritura kundrejt pagesave që janë për t'u kryer sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së me nr. 22.0256.0801 në Landeszentralbank, Frankfurt am Main, (BLZ 500 204 00), nuk lejohen kundërankimet kundrejt këtyre pagesave.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e parakohshme

5.1 Huamarrësi mundet që në çdo kohë:

a) të mos plotësojë detyrimet e tij në bazë të nenit 8, të anulojë çdo shumë të huasë të padisbursuar;

b) të paguajë huanë në tërësi ose pjesërisht përpara afatit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç rastit kur:

a) Huamarrësi ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së, për kryerjen e pagesave në kohë;

b) janë shkelur detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet e veçanta që janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje;

c) Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të vërtetojë se shumatat e huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;

d) krijohen rrethana të veçanta që bëjnë të pamundur ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit ose pagesën e detyrimeve financiare të Huamarrësit të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5.3 Nëse rrethanat e përcaktuara në nenin 5.2 a), b) ose c) janë krijuar dhe nuk janë eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë, të paktën prej 30 ditë, KfW-ja mund:

a) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 a), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të huasë të papaguara si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrime të tjera të rastit.

b) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 b), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të huasë të papaguara si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrime të tjera të rastit.

c) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 c), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të tilla të huasë, për të cilat Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

Neni 6
Kostoja dhe pagesat publike

6.1 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat e përcaktuara nga kjo Marrëveshje pa zbritur nga këto të fundit taksat, pagesat publike, si dhe kosto të tjera, dhe do të mbulojë koston e transferimit dhe të shkëmbimit që kanë të bëjnë me disbursimin e huasë.

6.2 Huamarrësi do të mbulojë koston e të gjitha taksave dhe shpenzimeve të tjera publike të lindura, jashtë territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
**Vlefshmëria e huasë, marrëveshjes për projekte
dhe financim, si dhe përfaqësuesia**

7.1 Përpara disbursimit të parë, Huamarrësi do të sigurojë prova të kënaqshme për KfW-në, të cilat vërtetojnë që Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhje me kushtetutën e tij, si dhe ligjet e tjera për marrjen e vlefshme mbi vete të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

7.2 Ministri i Fincancave dhe individë, të përcaktuar nga ai me specimen tek KfW-ja dhe të autorizuar nga ai, do të përfaqësojnë Huamarrësin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së zbatimit dhe individë të tillë të përcaktuar nga ai do të përfaqësojnë Agjencinë zbatuese në zbatimin e Marrëveshjes. Prokurat nuk do të përfundojnë derisa KfW-ja të marrë njoftimin për anulimin e tyre nga përfaqësuesit e autorizuar.

7.3 Amendamente ose adendume të kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftime të bëra nga Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim. Njoftimet dhe komunikimet do të dërgohen në adresat e mëposhtme të Palëve Kontraktuese përkatëse ose në ndonjë adresë tjetër të Palëve Kontraktuese korrespondente, siç i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW-në: Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Telefax: + 49 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Al- Tirana
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese: Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizimeve
Berat dhe Kuçovë
Berat - Shqipëri

7.4 Amendamente të kësaj Marrëveshjeje, që kanë të bëjnë vetëm me marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë zbatuese të projektit.

Neni 8
Projekti

8.1 Agjencia zbatuese:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe do t'u përmbahet praktikave të drejta financiare dhe ndërtuese në lidhje me projektin, si dhe në përputhje me idenë e projektit, për të cilën është rënë dakord ndërmjet KfW-së dhe Agjencisë zbatuese;

b) do të përgatisë dhe mbikëqyrë ekzekutimin e projektit nëpërmjet kontraktimit të një

koncesionari të përzgjedhur me tender të hapur ndërkombëtar;

c) do të akordojë kontratat për mallrat dhe shërbimet, të cilat do të financohen nga huaja në përputhje me procedurat ndërkombëtare të tenderimit;

d) do të mbajë të dhëna, të cilat tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për projektin dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë tipin e mallit dhe të shërbimit të financuar nga kjo hua;

e) do të bëjë të mundur që përfaqësues të KfW-së të mundin në çdo kohë t'i kontrollojnë këto të dhëna, si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zbatimin e projektit, si dhe të vizitojnë zonën e projektit, si dhe objektet përkatëse;

f) do t'i sigurojnë KfW-së dhe Ministrisë së Financave çdo informacion dhe të dhëna mbi projektin dhe mbi ecurinë e tij sipas kërkesës së KfW-së ose të Ministrisë së Financave.

8.2 Agjencia Zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e nenit 8.1 nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë.

Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, nëse i kërkohet, t'i sigurojë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk mbulohen nga huaja janë mbuluar;

b) me iniciativën e tyre, të informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të sigurojë që, përpara disbursimit të parë të fondeve të projektit për mallra dhe shërbimet nga pjesa e investimit, të gjitha borxhet dhe detyrimet e trashëguara, të ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve të Beratit dhe Kuçovës, deri në datën e bashkimit të tyre legal me përgjegjësi të përbashkët për zbatimin e projektit, janë shlyer ose janë marrë përsipër nga një palë e tretë.

8.5 Huamarrësi do të asistojë në Agjencinë zbatuese në përputhje me praktika të drejta financiare dhe ndërtuese gjatë zbatimit të projektit, si dhe në shlyerjen e detyrimeve të Agjencisë zbatuese që përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe, veçanërisht, t'i akordojë Agjencisë zbatuese të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

8.6 Transporti i mallrave që do të financohet nga huaja do t'i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjes qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi.

Neni 9

Dispozita të tjera

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese do të sigurojnë se personat e përgjegjshëm për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e kontratës mbi mallrat dhe shërbimet që do të financohen, dhe që bëjnë kërkesën për disbursimin e shumave të huasë të mos kërkojnë, japin, premtojnë ose marrin premtimin për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk është e vlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të qëndrojnë të pandryshueshme. Boshllëqet e krijuara si pasojë do të mbushen nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese e projektit nuk mund të caktojnë, transferojnë, garantojnë ose hipotekojnë një të drejtë të tyre të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i punës do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në lidhje me interpretimin e Marrëveshjes, do të mbizotërojë teksti në gjuhën gjermane.

9.5 Të gjitha konfliktet që vijnë nga kjo Marrëveshje, si dhe ato mbi vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve Kontraktuese, do t'u nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo Marrëveshje për projekt, hua dhe financim nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë sa marrëveshja qeveritare, mbi të cilën ajo bazohet, nuk ka hyrë në fuqi.

Nënshkruar në 6 kopje origjinale, tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

MARRËVESHJE ARBITRAZHI

Në mbështetje të nenit 9.5 të Marrëveshjes së Projektit për Hua dhe Financim, Ndërmjet KfW-Së dhe REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) përfaqësuar nga MINISTRIA E FINANCAVE Tiranë, Si dhe Ndërmarrja e UjësjetësIT Berat dhe Kuçovë (Agjencia zbatuese) Ujësjetës për Shqipërinë e Mesme Komponenti Berat-Kuçovë

KfW-ja Huamarrësi dhe Agjencia e zbatimit të projektit bie dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Të gjitha konfliktet në lidhje me Marrëveshjen për hua dhe financim projekti, si dhe në lidhje me vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht nga Palët Kontraktuese do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjyq arbitrazhi.

Neni 2

Palët në procedurat e arbitrazhit do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. KfW-ja ka të drejtën të nisë veprime kundër Huamarrësit dhe Agjencisë zbatuese, në mënyrë të ndarë ose të përbashkët. Po kështu, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese kanë të drejtën të nisin veprimet së bashku ose individualisht kundër KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjyqtaria e arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar si vijon: një gjyqtar do të emërohet nga vetë Huamarrësi ose, nëse Huamarrësi nuk ka ndërhyrë akoma në procedura, nga Agjencia zbatuese; gjyqtari i dytë nga KfW-ja dhe gjyqtari i tretë (kryetari) do të emërohet me marrëveshje të Palëve ose, nëse Palët nuk bien dakord brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga i akuzuari, do të emërohet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë ose, në rastin e dështimit, do të emërohet nga Kryetari i Komitetit Kombëtar të Zvicrës i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse njëra nga Palët dështon në emërimin e gjyqtarit ai do të emërohet nga kryetari.

3.2 Në rast se një arbitruës i emëruar në përputhje me dispozitat paraardhëse dëshiron të japë dorëheqjen ose është i paafte për të vepruar si arbitruës, pasardhësi i tij emërohet në të njëjtën mënyrë. Pasardhësi ka të njëjtat kompetenca si dhe arbitruësi fillestar.

Neni 4

4.1 Procedurat e arbitrazhit do të fillojnë me anë të dorëzimit të një komunikimi me shkrim të akuzës së një pale kundrejt palës tjetër. Ky komunikim duhet të japë natyrën e akuzës, kompensimin që kërkohet, si dhe emrin e gjyqtarit që akuzuesi ka emëruar, në rastin kur akuzuesi është i autorizuar të emërojë një gjyqtar siç parashikon neni 3.1 i kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Tridhjetë ditë pas marrjes së komunikimit, i akuzuari duhet të njoftojë akuzuesin për emrin e gjyqtarit të emëruar nga ai, në rastin kur i akuzuari është i autorizuar të emërojë një gjyqtar në përputhje me nenin 3.1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Gjykata e arbitrazhit do të mbledhet në kohën e përcaktuar nga kryetari. Në rastin kur Palët nuk kanë rënë dakord për vendin ku do të zhvillohen procedurat e arbitrazhit, vendi do të përcaktohet nga kryetari.

Neni 6

Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë në bazë të kompetencave të tij. Ai do të përcaktojë procedurat

e tij në përputhje me rregulla procedure të pranuar gjerësisht. Në çdo rast, Palët kanë të drejtën e një shpjegimi në një seancë të rregullt. Gjyqi i arbitrazhit mund të marrë vendim, edhe nëse njëra nga Palët dështon të paraqitet në proces. Të gjitha vendimet e gjyqit të arbitrazhit kërkojnë aprovimin e të paktën dy prej gjyqtarëve.

Neni 7

Gjyqi i arbitrazhit do të japë vendimin së bashku me arsyet shoqëruese me shkrim. Vendimi i nënshkruar nga të paktën dy gjyqtarë do të përbëjë dhe vendimin e gjyqit të arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një kopje të nënshkruar të vendimit. Vendimi është ligjërisht detyrues dhe përfundimtar. Duke nënshkruar këtë Marrëveshje të dy Palët pranojnë detyrimin për t'iu nënshtuar këtij vendimi.

Neni 8

8.1 Palët bien dakord për shpërblimin e gjyqtarëve dhe individëve të tjerë që do të nevojiten për kryerjen e procedurave të arbitrazhit.

8.2 Në rastin kur Palët nuk bien dakord përpara mbledhjes së gjyqit të arbitrazhit, gjyqi i arbitrazhit do të përcaktojë një shpërblim të përshtatshëm. Secila Palë do të mbulojë shpenzimet e saj në lidhje me procedurat e arbitrazhit. Kostoja e gjyqit të arbitrazhit do të mbulohet, nga Pala, kundër së cilës do të merret vendimi. Nëse vendimi nuk do të jetë plotësisht në favor të asnjërës nga palët, kostoja do të mbulohet nga të dy Palët, në mënyrë të barabartë.

8.3 Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë përfundimisht për të gjitha çështjet që lidhen me koston.

8.4 Palët janë ligjërisht të detyruara, individualisht ose së bashku, për pagimin e shpërblimit të individëve të përcaktuar në nenin 8.1.

Neni 9

Të gjitha njoftimet e bëra nga Palët dhe Gjykata e Arbitrazhit në lidhje me procedurat e arbitrazhit do të jenë me shkrim. Njoftime të tilla do të merren pasi të dërgohen në adresat e mëposhtme të Palëve Kontraktuese përkatëse ose në ndonjë adresë tjetër të Palëve Kontraktuese përkatësisht, siç i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese.

Për KfW

Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Telefax: + 49 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin

Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Al- Tirana
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese

Ndërmarrja Ujësjetës-Kanalizimeve Berat
dhe Kuçovë
Al – Berat/ Shqipëri

Nënshkruar në gjashtë kopje origjinale tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

L I G J
Nr.9044, datë 3.4.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE TË
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË I SHQIPËRISË SË MESME, KOMPONENTI
LUSHNJË”, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS GJERMANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KFW)”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, e financimit dhe e projektit “Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme, komponenti Lushnjë”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3784, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

PËR HUA, FINANCIM DHE PROJEKT NDËRMJET KREDITANSTALT FUT WIEDERAUFBAU, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, TIRANË, SI DHE NDËRMARRJA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE LUSHNJË SH.A. (AGJENCIA ZBATUESE) PËR 4 601 626, 93 EURO – HUA (INVESTIM) DHE 370 000,00) EURO – KONTRIBUT FINANCIAR (MASA TRAJNUESE)

Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme

Ujësjiellësi Lushnjë

Në bazë të një marrëveshjeje që pritet të përfundojë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim financiar (marrëveshje qeveritare), Huamarrësi “Agjencia zbatuese” dhe KfW-ja me anë të kësaj lidhin këtë Marrëveshje për hua, financim dhe projekt.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi

1.1 KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk e kalon shumën 4 601 629, 93 euro (investimi) dhe një kontribut financiar që nuk kalon shumën 370 000 00 euro (masa trajnuese).

Kontributi financiar nuk mund të ripaguhet, vetëm nëse artikulli 4.2 parashikon ndryshe.

1.2 Huamarrësi do t’ia kalojë të gjithë shumën e huasë dhe kontributin financiar Agjencisë zbatuese në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia zbatuese do ta përdorë huanë vetëm për financimin e nxjerrjes, transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për zonën e

ujësjellësit të Lushnjës, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës, dhe kontributin financiar vetëm për mbështetjen institucionale që shoqëron këtë proces, së pari për të mbuluar koston e shkëmbimit të huaj ("Projekti"). Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar në një marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksa dhe tatime të tjera publike të hasura nga Huamarrësi ose Agjencia zbatuese, si dhe taksat e importit nuk do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar.

Neni 2

Kalimi i huasë dhe kontributit financiar tek Agjencia zbatuese

2.1 Huamarrësi do ta kalojë huanë tek Agjencia zbatuese në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në nenin 4.2 dhe 4.4 të kësaj Marrëveshjeje.

2.2 Huamarrësi do ta kalojë kontributin financiar tek Agjencia zbatuese në formën e një granti të pakthyeshëm në përputhje me një marrëveshje të veçantë financimi.

2.3 Përpara disbursimit të parë nga huaja dhe kontributit financiar, Huamarrësi do t'i dorëzojë KfW-së një kopje të Marrëveshjes së cilës i referohet neni 2.1 dhe 2.2.

2.4 Kalimi i huasë dhe kontributit financiar nuk përbën asnjë detyrim ligjor të Agjencisë zbatuese kundrejt KfW-së në lidhje me detyrime për pagesat që kjo Marrëveshje përcakton.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja do të bëjë disbursimin e huasë dhe të kontributit financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë zbatuese. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë metodat e disbursimit, veçanërisht provat që do të vërtetojnë që fondet e tërhequra përdoren për qëllimet e përcaktuara.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor 2006.

Neni 4

Taksa e angazhimit, interesat dhe pagesa e huasë

4.1 Huamarrësi do të paguajë një taksë prej 0.25% në vit për shuma të padisbursuara të huasë. Kjo taksë do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që përfundon në datën kur disbursimet debitojnë.

4.2 Huamarrësi do të paguajë një interes për huanë prej 0.75% në vit. Interesi do të zbatohet duke filluar nga data e debitimit të disbursimit deri në datën e bërjes së pagesave në llogarinë bankare të KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë detyrimin e angazhimit, interesin dhe çdo interes për vonesa në pagesë në bazë të nenit 4.5 në 30 qershor dhe në 30 dhjetor për gjysmën e vitit në përfundim. Detyrimi i parë i angazhimit do të shlyhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi do të paguajë huanë si vijon:

Kësti	Datë		Shuma
1	30 dhjetor	2012 Euro	76 000,00
2	30 qershor	2013 Euro	76 000,00
3	30 dhjetor	2013 Euro	76 000,00
4	30 qershor	2014 Euro	76 000,00
5	30 dhjetor	2014 Euro	76 000,00
6	30 qershor	2015 Euro	76 000,00
7	30 dhjetor	2015 Euro	76 000,00
8	30 qershor	2016 Euro	76 000,00
9	30 dhjetor	2016 Euro	76 000,00
10	30 qershor	2017 Euro	76 000,00
11	30 dhjetor	2017 Euro	76 000,00

12	30 qershor	2018 Euro	76 000,00
13	30 dhjetor	2018 Euro	76 000,00
14	30 qershor	2019 Euro	76 000,00
15	30 dhjetor	2019 Euro	76 000,00
16	30 qershor	2020 Euro	76 000,00
17	30 dhjetor	2020 Euro	76 000,00
18	30 qershor	2021 Euro	76 000,00
19	30 dhjetor	2021 Euro	77 000,00
20	30 qershor	2022 Euro	77 000,00
21	30 dhjetor	2022 Euro	77 000,00
22	30 qershor	2023 Euro	77 000,00
23	30 dhjetor	2023 Euro	77 000,00
24	30 qershor	2024 Euro	77 000,00
25	30 dhjetor	2024 Euro	77 000,00
26	30 qershor	2025 Euro	77 000,00
27	30 dhjetor	2025 Euro	77 000,00
28	30 qershor	2026 Euro	77 000,00
29	30 dhjetor	2026 Euro	77 000,00
30	30 qershor	2027 Euro	77 000,00
31	30 dhjetor	2027 Euro	77 000,00
32	30 qershor	2028 Euro	77 000,00
33	30 dhjetor	2028 Euro	77 000,00
34	30 qershor	2029 Euro	77 000,00
35	30 dhjetor	2029 Euro	77 000,00
36	30 qershor	2030 Euro	77 000,00
37	30 dhjetor	2030 Euro	77 000,00
38	30 qershor	2031 Euro	77 000,00
39	30 dhjetor	2031 Euro	77 000,00
40	30 qershor	2032 Euro	77 000,00
41	30 dhjetor	2032 Euro	77 000,00
42	30 qershor	2033 Euro	77 000,00
43	30 dhjetor	2033 Euro	77 000,00
44	30 qershor	2034 Euro	77 000,00
45	30 dhjetor	2034 Euro	77 000,00
46	30 qershor	2035 Euro	77 000,00
47	30 dhjetor	2035 Euro	77 000,00
48	30 qershor	2036 Euro	77 000,00
49	30 dhjetor	2036 Euro	77 000,00
50	30 qershor	2037 Euro	77 000,00
51	30 dhjetor	2037 Euro	77 000,00
52	30 qershor	2038 Euro	77 000,00
53	30 dhjetor	2038 Euro	77 000,00
54	30 qershor	2039 Euro	77 000,00
55	30 dhjetor	2039 Euro	77 000,00
56	30 qershor	2040 Euro	77 000,00
57	30 dhjetor	2040 Euro	77 000,00
58	30 qershor	2041 Euro	77 000,00
59	30 dhjetor	2041 Euro	77 000,00
60	30 qershor	2042 Euro	76 626,93
Total		Euro	4 601 626, 93

4.5 Nëse këstet nuk paguhen në kohë, KfW-ja rezervon të drejtën të rrisë përqindjen e interesit për vonesat në pagesë sipas përqindjes së interesit të bankës gjermane në datën përkatëse duke i shtuar 3% në vit për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur kjo pagesë derdhet në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9 të kësaj Marrëveshjeje. Në rast të

mospagesave të interesave, KfW-ja ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. Këto dëmshpërblime nuk do ta kapërcejnë shumën momentale, në qoftë se llogariten në kurs zbritës të Deutsche Bundesbank të datës së maturimit plus 3% në vit.

4.6 Tarifa e angazhimit, interesi, si dhe çdo taksë për mospagesa sipas nenit 4.5 do të llogariten në bazë të vitit 360 ditësh dhe muajit 30 ditësh.

4.7 Sasi të huasë të padisbursuara ose të shlyera përpara afatit do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha transheve të shlyerjes së papaguar, përveçse kur KfW-ja vendos vetë sipas një mënyre të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave më të vogla.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, sipas dëshirës së saj, pagesat e mbërritura kundrejt pagesave që janë për t'u kryer sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së me nr.22.0256.0801 në Landeszentralbank, Main, Frankfurt (BLZ 500 204 00); nuk lejohen kundërankimet kundrejt këtyre pagesave.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e parakohshme

5.1 Huamarrësi mundet që në çdo kohë:

a) të mos plotësojë detyrimet e tij në bazë të nenit 8, të anulojë çdo shumë të huasë ose të kontributit financiar të padisbursuar;

b) të paguajë huanë në tërësi ose pjesërisht përpara afatit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç rastit kur:

a) Huamarrësi ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së, për kryerjen e pagesave në kohë.

b) Janë shkelur detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet e veçanta që janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

c) Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të vërtetojë se shumatat e huasë dhe të kontributit financiar janë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

d) Krijohen rrethana të veçanta që bëjnë të pamundur ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit, ose pagesën e detyrimeve financiare të Huamarrësit të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5.3 Nëse rrethanat e përcaktuara në nenin 5.2 a), b) ose c) janë krijuar dhe nuk janë eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila do të jetë të paktën prej 30 ditësh, KfW mund:

a) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 a), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të huasë së papaguar, si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrime të tjera të rastit.

b) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 b), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të kontributit financiar, si dhe pagimin e të gjitha interesave të mbledhura, si dhe detyrimet e tjera të rastit.

c) Në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 c), të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumave të tilla të huasë dhe kontributit financiar, për të cilat Agjencia zbatuese nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimet e përcaktuara.

Neni 6

Kostoja dhe pagesat publike

6.1 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat e përcaktuara nga kjo Marrëveshje pa zbritur nga këto të fundit taksat, pagesat publike, si dhe kosto të tjera dhe do të mbulojë koston e transferimit dhe të shkëmbimit që kanë të bëjnë me disbursimin e huasë.

6.2 Huamarrësi do të mbulojë koston e të gjitha taksave dhe shpenzimeve të tjera publike, jashtë territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Vlefshmëria e huasë, marrëveshje për projekte dhe financim, si dhe përfaqësuesia

7.1 Përpara disbursimit të parë, Huamarrësi do të sigurojë provat e kënaqshme për KfW-në, të cilat vërtetojnë që Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhje me kushtetutën e tij, si dhe legjislaturën tjetër për marrjen e vlefshme mbi vete të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

7.2 Ministri i Financave dhe individë të përcaktuar nga ai tek KfW-ja dhe të autorizuar me anë të firmave të autorizuar nga ai do të përfaqësojnë Huamarrësin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë ekzekutive dhe individë të tillë të përcaktuar nga ajo do të përfaqësojnë Agjencinë zbatuese në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Prokurat nuk do të përfundojnë derisa KfW-ja të marrë njoftimin për anulimin e tyre nga përfaqësuesit e autorizuar.

7.3 Amendamente ose adendume të kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftime të bëra nga Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim. Njoftimet dhe komunikimet do të dërgohen në adresat e mëposhtme të Palëve Kontraktuese përkatëse ose në ndonjë adresë tjetër të Palëve Kontraktuese përkatëse, siç i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese:

Për KfW-në	Kreditanstalt für Wiederaufbau Postfach 11 11 41 D-60046 Frankfurt am Main Federal Republic of Germany Telefax: +49 69 74 31 29 44 Telex: 4 15 25 60 kw d
------------	--

Për Huamarrësin	Ministria e Financave Bul.Dëshmorët e Kombit Al-Tirana Republika e Shqipërisë Telefax: +355 42 28494
-----------------	--

Për Agjencinë zbatuese	Ndërmarrja Ujësjetellës-Kanalizimeve Lushnjë, Shqipëri
------------------------	---

7.4 Amendamente të kësaj Marrëveshjeje që kanë të bëjnë vetëm me marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovimin e Agjencisë zbatuese.

Neni 8

Projekti

8.1 Agjencia zbatuese:

a) Do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe t'u përmbahet praktikave të drejta financiare dhe ndërtuese në lidhje me projektin, si dhe në përputhje me idenë e projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet KfW-së dhe Agjencisë zbatuese.

b) Do të zgjedhë firma konsulente independente dhe të kualifikuara për përgatitjen dhe mbikëqyrjen, dhe firma të kualifikuara për zbatimin e projektit.

c) Do të akordojë kontratat për mallrat dhe shërbimet të cilat do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar në përputhje me procedurat ndërkombëtare të tenderimit.

d) Do të mbajë të dhëna, të cilat tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për projektin dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë tipin e mallit dhe të shërbimit të financuar nga kjo hua dhe këto kontribute financiare.

e) Do të bëjë të mundur që përfaqësues të KfW-së të mundin në çdo kohë të kontrollojnë këto të dhëna, si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zbatimin e projektit, si dhe të vizitojnë zonën e projektit, si dhe objekte përkatëse.

f) Do t'i sigurojnë KfW-së dhe Ministrisë së Financave çdo informacion dhe të dhëna mbi Projektin dhe mbi ecurinë e tij sipas kërkesës së KfW-së ose të Ministrisë së Financave.

g) Para disbursimit të parë të fondeve të bashkëpunimit financiar për projektin kryesor (veçmas nga programi i mëparshëm i matjes së ujit) duhet t'i paraqesë KfW-së prova se përqindja e mbledhjes së tarifave të ujit ka qenë vazhdimisht mbi 80% për një periudhë prej të paktën 3 muajsh.

h) Para disbursimit të parë të fondeve të bashkëpunimit financiar për projektin të ketë rënë dakord me bashkinë e Lushnjës në mënyrë legale për një planveprim, i cili të sigurojë rritjen e tarifave mesatare të ujit minimumi në nivelin 51 lekë/m³ deri në vitin 2005.

8.2 Agjencia zbatuese dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e nenit 8.1 nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, nëse i kërkohet, t'i sigurojë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk mbulohen nga huaja ose nga kontributi financiar janë mbuluar;

b) me iniciativën e tyre, të informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi do të sigurojë që, përpara disbursimit të parë të fondeve të projektit për mallrat dhe shërbimet nga pjesa e investimit, të gjitha borxhet dhe detyrimet e mbledhura nga Agjencia zbatuese, deri në datën e kthimit të saj në një shoqëri aksionere, janë shlyer ose marrë përsipër nga një palë e tretë.

8.5 Huamarrësi do të asistojë Agjencinë zbatuese në përputhje me praktika të drejta financiare dhe ndërtuese gjatë zbatimit të projektit, si dhe në shlyerjen e detyrimeve të Agjencisë zbatuese që përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe, veçanërisht, t'i akordojë Agjencisë zbatuese të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

8.6 Transporti i mallrave, që do të financohet nga huaja dhe kontributi financiar, do t'i nënshtrohet dispozitave të marrëveshjes qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi.

Neni 9

Dispozita të tjera

9.1 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese do të sigurojnë se personat e përgjegjshëm për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e kontratës mbi mallrat dhe shërbimet që do të financohen, dhe që bëjnë kërkesën për disbursimin e shumave të huasë të mos kërkojnë, japin, premtojnë ose marrin premtimin për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk është e vlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të qëndrojnë të pandryshueshme. Boshllëqet e krijuara si pasojë do të mbushen nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese

9.4 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga legjislatura e Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i punës do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në lidhje me interpretimin e Marrëveshjes, do të mbizotërojë teksti në gjuhën gjermane.

9.5 Të gjitha konfliktet që vijnë nga kjo Marrëveshje, si dhe ato mbi vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve Kontraktuese do t'u nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo Marrëveshje për projekt, hua dhe financim nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë, sa marrëveshja qeveritare, mbi të cilën ajo bazohet nuk ka hyrë në fuqi.

Nënshtrohet në 6 kopje origjinale, tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

MARRËVESHJE ARBITRAZHI

Në mbështetje të nenit 9.5 të Marrëveshjes së Projektit për Hua dhe Financim ndërmjet KreditInsaTALT für Wiederaufbau ("KfW") dhe Republikës së Shqipërisë (HUAMARRËSI) përfaqësuar nga Ministria e Financave Tiranë, si dhe Ndërmarrja e Ujësjetllës- kanalizimeve, Lushnjë (AGJENCIA ZBATUESE)

KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese bien dakord për sa vijon.

Neni 1

Të gjitha konfliktet në lidhje me Marrëveshjen për hua, financim dhe projekt dhe në lidhje me vlefshmërinë e Marrëveshjes për hua, financim dhe projekt, si dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht nga Palët Kontraktuese do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjyq arbitrazhi.

Neni 2

Palët në procedurat e arbitrazhit do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. KfW-ja ka të drejtën të nisë veprime kundër Huamarrësit dhe Agjencisë zbatuese, në mënyrë të ndarë ose të përbashkët. Po kështu, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese kanë të drejtën të nisin veprimet së bashku ose individualisht kundër KfW-së.

Neni 3

3.1 Gjyqtaria e arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar si vijon: një gjyqtar do të emërohet nga vetë Huamarrësi ose, nëse Huamarrësi nuk ka ndërhyrë akoma në procedura, nga Agjencia zbatuese; gjyqtari i dytë nga KfW-ja dhe gjyqtari i tretë (kryetari) do të emërohet me marrëveshje të Palëve ose, nëse Palët nuk bien dakord brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrazh nga i akuzuari, do të emërohet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë ose, në rastin e dështimit, do të emërohet nga Kryetari i Komitetit Kombëtar të Zvicrës i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse njëra nga Palët dështon në emërimin e gjyqtarit ai do të emërohet nga kryetari.

3.2 Në rast se një arbitruer i emëruar në përputhje me dispozitat paraardhëse, dëshiron të japë dorëheqjen ose është i paaftë për të vepruar si arbitruer, pasardhësi i tij emërohet në të njëjtën mënyrë. Pasardhësi ka të njëjtat kompetenca si dhe arbitruesi fillestar.

Neni 4

4.1 Procedurat e arbitrazhit do të fillojnë me anë të dorëzimit të një komunikimi me shkrim të akuzës së një pale kundrejt palës tjetër. Ky komunikim duhet të japë natyrën e akuzës ose kompensimin që kërkohet, si dhe emrin e gjyqtarit që akuzuesi ka emëruar, në rastin kur akuzuesi është i autorizuar të emërojë një gjyqtar, siç parashikon neni 3.1 i kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Tridhjetë ditë pas marrjes së komunikimit, i akuzuari duhet të njoftojë akuzuesin për emrin e gjyqtarit të emëruar nga ai, në rastin kur i akuzuari është i autorizuar të emërojë një gjyqtar në përputhje me nenin 3.1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Gjykata e Arbitrazhit do të mbledhet në kohën e përcaktuar nga kryetari. Në rastin kur palët nuk kanë rënë dakord për vendin ku do të zhvillohen procedurat e arbitrazhit, vendi do të përcaktohet nga kryetari.

Neni 6

Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë në bazë të kompetencave të tij. Ai do të përcaktojë procedurat e tij në përputhje me rregulla procedure të pranura gjerësisht. Në çdo rast, Palët kanë të drejtën e një shpjegimi në një seancë të rregullt. Gjyqi i arbitrazhit mund të marrë vendim, edhe nëse njëra nga Palët dështon të paraqitet në proces. Të gjitha vendimet e gjyqit të arbitrazhit kërkojnë aprovimin e të paktën e dy prej gjyqtarëve.

Neni 7

Gjyqi i arbitrazhit do të japë vendimin së bashku me arsyet shoqëruese me shkrim. Vendimi i nënshkruar nga të paktën dy gjyqtarë do të përbëjë dhe vendimin e gjyqit të arbitrazhit. Secila Palë do të marrë një kopje të nënshkruar të vendimit. Vendimi është ligjërisht detyrues dhe përfundimtar. Duke nënshkruar këtë Marrëveshje të dy Palët pranojnë detyrimin për t'iu nënshtruar këtij vendimi.

Neni 8

8.1 Palët bien dakord për shpërblimin e gjyqtarëve dhe individëve të tjerë që do të nevojiten për kryerjen e procedurave të arbitrazhit.

8.2 Në rastin kur palët nuk bien dakord përpara mbledhjes së gjyqit të arbitrazhit, gjyqi i arbitrazhit do të përcaktojë një shpërblim të përshtatshëm. Secila palë do të mbulojë shpenzimet e saj në lidhje me procedurat e arbitrazhit. Kostot e gjyqit të arbitrazhit do të mbulohen nga Pala kundër së cilës do të merret vendimi. Nëse vendimi nuk do të jetë plotësisht në favor të asnjërës nga Palët, kostoja do të mbulohet nga të dy Palët, në mënyrë të barabartë.

8.3 Gjyqi i arbitrazhit do të vendosë përfundimisht për të gjitha çështjet që lidhen me koston.

8.4 Palët janë ligjërisht të detyruara, individualisht ose së bashku, për pagimin e shpërblimit të individëve të përcaktuar në nenin 8.1.

Neni 9

Të gjitha njoftimet e bëra nga palët dhe Gjykata e Arbitrazhit në lidhje me procedurat e arbitrazhit do të jenë me shkrim. Njoftime të tilla do të merren pasi të dërgohen në adresat e mëposhtme të Palëve Kontraktuese përkatëse ose në një tjetër adresë të Palëve Kontraktuese përkatëse siç i njoftohet Palës tjetër Kontraktuese:

Për KfW-në

Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
D-60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Telefax: + 49 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kw d

Për Huamarrësin

Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Al-Tirana
Republika e Shqipërisë
Telefax: + 355 42 28494

Për Agjencinë zbatuese

Ndërmarrja Ujësjiellës-Kanalizimeve Lushnjë

Nënshkruar në gjashtë kopje origjinale, tre në gjermanisht dhe tre në anglisht.

D E K R E T
Nr.3728, datë 13.3.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-------------------------------------|---|
| 1. Laureta Stavri Kratellari | 32. Tak Filip Franja |
| 2. Leonard Gjergj Anadollaku | 33. Besnik Hasan Sharra |
| 3. Bajram Xhevit Kalemi | 34. Fiona Besnik Sharra |
| 4. Klaus Bajram Kalemi | 35. Mirela Qerim Sharra (Toro) |
| 5. Hysni Ramazan Sefa | 36. Anila Burhan Xhembulla |
| 6. Armand Hysni Sefa | 37. Roland Adem Ago |
| 7. Elvis Hysni Sefa | 38. Arben Gani Banda |
| 8. Ariana Ulsi Sefa (Agolli) | 39. Bersant Arben Banda |
| 9. Antoneta Hysni Sefa | 40. Resmie Abdyl Banda (Kapxhiu) |
| 10. Agron Shefqet Koçi | 41. Jonida Arben Banda |
| 11. Mervete Xhemal Feuerer (Hoti) | 42. Armando Arben Banda |
| 12. Kujtim Bajram Bizgjoni | 43. Niko Vangjel Frashëri |
| 13. Adrian Kozma Stefi | 44. Enver Elmaz Libohova |
| 14. Esma Xhemal Riedinger (Dibra) | 45. Shkëlqim Mustafa Vokri |
| 15. Fiqiri Fadil Doka | 46. Eleftherios Sotir Lionis |
| 16. Artur Hajdar Sheqeri | 47. Sophia Eleftherios Lioni |
| 17. Agim Hysen Metani | 48. Sokol Daut Pelinku |
| 18. Fatbardha Rahim Mertani (Dauti) | 49. Nelsi Sokol Pelinku |
| 19. Sokol Hiqmet Gonxhja | 50. Patrick Sokol Pelinku |
| 20. Sokol Mentor Ruli | 51. Suela Ksenofon Pelinku (Lamani) |
| 21. Gea Sokol Ruli | 52. Dritan Todi Fers (Ndoni) |
| 22. Vasilika Shyqyri Ruli (Çuka) | 53. Robert Sefer Duçellari |
| 23. Arta Myfit Mahmutaj | 54. Sarah Robert Duçellari |
| 24. Xhavit Haxhi Harizi | 55. Vjollca Beqir Duçellari (Llabunishti) |
| 25. Fuada Xhavit Harizi | 56. Diana Abas Hoxha |
| 26. Alma Ferit Halili | 57. Armando Myqerem Meqemeja |
| 27. Genti Beniamin Dyrnjaja | 58. Diana Bajram Xibraku |
| 28. Viktor Fran Çukaj | 59. Yllka Ylli Velia |
| 29. Saimir Kujtim Gjebrea | 60. Jürgen Ylli Velia |
| 30. Lijeta Rustem Kodra (Mahmutaj) | 61. Rejnalda Ylli Velia |
| 31. Gentiana Naim Kodra | 62. Arben Mustafa Murizi |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 9.5.2003

Doli nga shtypi më 10.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë